

Në bazë të nenit 3 dhe 4, nenit 34 paragrafi 1 dhe nenit 40 paragrafit 1 të Ligjit mbi pronën shtetërore („Fletorja zyrtare e MZ“ nr.21/09 dhe 40/11), Rregullores mbi shitjen dhe dhënien me qira të gjërave në pronësi shtetërore („Fletorja zyrtare e MZ“ nr. 21/09 dhe 40/11, nenit 28,29 dhe 30 të Vendimit mbi vendosjen, ndërtimin dhe përshtatjen e objekteve të përkohshme të karakterit montues në territorin e Komunës së Tuzit („Fletorja zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale“, nr. 20/20), Vendimit mbi dhënien me qira të truallit në të cilin vendosen objektet e përkohshme („Fletorja zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale“, numër / 21), neni 28 dhe 29 i Vendimit mbi dhënien e pëlqimit ndaj Komunës së Tuzit për zbatimin e procedurës së dhënies me qira të truallit në territorin e saj me qëllim të vendosjes së objekteve të përkohshme („Fletorja zyrtare e MZ – dispozitat komunale“, nr. 20/20), Sekretariati për pronësi të Komunës së Tuzit, publikon

### FTESË PUBLIKE

#### për dhënien me qira të tokës për vendosjen e objekteve të përkohshme me karakter montues përmes mbledhjes së ofertave

Subjekti i ftesës publike është dhënia me qira e tokës për instalimin e objekteve të përkohshme me karakter montues, duke mbledhur oferta për lokacione nga lista e pronësisë numër 470 KK Tuz, si më poshtë:

#### TUZ QENDËR – ZONA 1

Numri i lokacionit	Lloji i objektit	Parcela kadastrale	Qellimi i objektit	Sipërfaqja e lokacionit në m <sup>2</sup>	Çmimi minimal i qirasë së truallit për m <sup>2</sup>
1.1	Objekti i përkohshëm montues-demontues	2242 KK Tuz	Kioskë	5.5 m <sup>2</sup>	
1.2	Objekti i përkohshëm montues-demontues	2242 KK Tuz	Kioskë	6.0 m <sup>2</sup>	
1.3	Objekti i përkohshëm montues-demontues	2242 KK Tuz	Kioskë	5.5 m <sup>2</sup>	
1.4	Objekti i përkohshëm montues-demontues	2242 KK Tuz	Bar i hapur me tarracë	30 m <sup>2</sup>	
1.5	Objekti i përkohshëm montues-demontues	2242 KK Tuz	Bar i hapur me tarracë	30 m <sup>2</sup>	
1.6	Objekti i përkohshëm montues-demontues	2242 KK Tuz	Bar i hapur me tarracë	25 m <sup>2</sup>	
1.7	Objekti i përkohshëm montues-demontues	2242 KK Tuz	Bar i hapur me tarracë	25 m <sup>2</sup>	
1.8	Objekti i përkohshëm montues-demontues	2242 KK Tuz	Bar i hapur me tarracë	25 m <sup>2</sup>	
1.9	Objekti i përkohshëm montues-demontues	2242 KK Tuz	Stendë	4 m <sup>2</sup>	

<b>1.10</b>	Objekti i përkohshëm montues-demontues	2242 KK Tuz	Stendë	4 m2	
<b>1.11</b>	Objekti i përkohshëm montues-demontues	2242 KK Tuz	Objekt për organizimi e evenimenteve (binë)	20 m2	
<b>33</b>	Objekti i përkohshëm montues-demontues	2242 KK Tuz	Kioskë	6 m2	
<b>32</b>	Objekti i përkohshëm montues-demontues	2242 KK Tuz	Kioskë	5.47 m2	

Toka jepet me qira për një periudhë prej një viti, me mundësinë e zgjatjes së qirasë, për vitin e ardhshëm më së gjati deri në një maksimum prej tre vjetësh, me kusht që qiramarrësi të ketë përmbushur detyrimet sipas kontratës, që kontrata të mos ndërpritet në mënyrë të njëanshme ose me marrëveshje të përbashkët ose në rast se është iniciuar procedurë gjyqësore mes Komunës së Tuzit dhe qiramarrësit për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve kontraktuale. Vendndodhjet e shënuara me numrat 1.4; 1.5; 1.6; 1.7; 1.8 jepen me qira për periudhën nga: 01.06.2021, deri më 30.09.2021, me mundësinë e zgjatjes së afatit për një muaj tjetër deri më 31.10.2021.

**Në shumën e arritur të qiradhënies për të gjitha lokacionet llogaritet TVSH-ja e cila është barrë e qiramarrësit. Paraqitja dhe shpenzimet – detyrimet e procedurës**

1) Të drejtën për të paraqitur oferta me shkrim e kanë personat fizik, sipërmarrësit dhe personat juridikë të regjistruar në Malin e Zi, përveç punonjësve në vetëqeverisjen lokale të Tuzit.

Oferta me shkrim duhet të përmbajë:

**Dëshmitë mbi aftësinë**

**a) Për personat fizik:**

- emrin dhe mbiemrin e ofertuesit me adresën e vendbanimit ose qëndrimit, numrin personal të identifikimit, gjegjësisht numrin amëz. adresën e postës elektronike dhe telefonin e kontaktit.

**b) për personat juridik:**

- emrin dhe selinë e personit juridik

- certifikatë nga Regjistri Qendror i Shoqërive ekonomike

- emri dhe mbiemri i drejtorit dhe nënshkrimi i tij, autorizimi - autorizimin për pjesëmarrje në ftesën publike.

2) Ofertën e shumës mujore të qirasë të shprehur në euro për qiranë e lokacionit të saktë.

3) Vërtetim i pagesës së depozitës me shënimin "depozitë për ftesë publike" në shumën prej 3 çmimeve minimale të qirasë mujore të lokacionit në llogarinë bankare të komunës Tuzi nr. 530-27038-88 Banka NLB.

4) Vërtetim se nuk ka detyrime të papaguara të bazuara në taksën e pasurive të patundshme ndaj komunës së Tuzit.

5) Aktvendimi për kryerjen e aktiviteteve për vitin paraprak (nëse ka një të tillë)

6) Vërtetim i kostove të paguara të procedurës në vlerë prej 20.00 euro.

Kostot e kryerjes së procedurës nuk rimbursohen.

Mënyra, vendi dhe koha e dorëzimit

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është data 27.05.2021, deri në orën 16 h.

Ftesa publike do të shfaqet në bordin e tabelën e lajmërimeve dhe në faqen e internetit të Komunës së Tuzit dhe do të publikohet në gazetën ditore "Pobjeda".

Aplikimet dorëzohen në një zarf të mbyllur të shënuar "aplikim për mbledhjen e ofertave për lokacionin nr. - Komisionit për kryerjen e procedurës së mbledhjes së ofertave, drejtpërdrejt në arkivin e Komunës së Tuzit ose me postë në adresën Tuz pn, 82106 Tuz.

Ofertat jashtë orarit të paraparë, jo të plota dhe të parregullta nuk do të merren parasysh.

Aplikantët nga paragrafi i mëparshëm nuk do të jenë në gjendje të regjistrohen në Komision.

#### **Vendi dhe koha e hapjes së ofertave**

Hapja e ofertave do të bëhet më 28.05.2021, duke filluar nga ora 10 në ndërtesën e komunës.

Aplikantët për pjesëmarrje në procedurën e mbledhjes së ofertave janë të detyruar të regjistrohen në Komision gjysmë ore para fillimit të procedurës.

Prania fizike e palëve të interesuara është e detyrueshme për pjesëmarrje në procedurën e hapjes së ofertave, përndryshe ofertat e shkruara pa prani fizike nuk do të merren parasysh.

#### **Përzgjedhja e ofertuesit më të favorshëm**

Ofertuesi më i favorshëm do të konsiderohet pjesëmarrësi që ofron shumën më të lartë të qirasë.

Nëse oferta është e pavlefshme ose nuk është e pranueshme, depozita i kthehet ofertuesit brenda 7 ditëve nga dita e procedurës.

Në rast se ofertuesi më i favorshëm tërhiqet nga qiraja pas hapjes së ofertës, ai humbet të drejtën për një rimbursim të depozitës dhe ofertuesi tjetër më i favorshëm do të ftohet të lidhë kontratën e qirasë.

Kriteret mbi zgjedhjen e ofertës më të favorshme:

- Çmimi më i lartë i ofruar.....60 pikë;
- Përdorimi i lokacionit në periudhën paraprake.....30 pikë;

Vendimi për zgjedhjen e ofertuesve më të favorshëm merret nga Komisioni për kryerjen e procedurës së mbledhjes së ofertave brenda 7 ditëve nga dita e hapjes së ofertave. Ai do të publikohet në tabelën e lajmërimeve dhe në faqen e internetit të Komunës së Tuzit, tuzi.org.me, brenda 7 ditëve nga dita e marrjes së vendimit. Njoftimet e veçanta për rezultatin e procedurës do t'u dërgohen të gjithë pjesëmarrësve që paraqitën oferta të sakta dhe të rregullta brenda 10 ditëve nga dita e hapjes së ofertës.

Pjesëmarrësit në procedurë kanë të drejtë të ankese ndaj vendimit për zgjedhjen e ofertuesve më të favorshëm brenda 5 ditëve nga data e marrjes së njoftimit ose nga data e publikimit të vendimit, nëse njoftimi nuk ka nevojë të paraqitet në përputhje me dispozitat e kësaj ftese publike.

Komisioni do të zbatojë dispozitat e Ligjit të Procedurës administrative në procedurën e ankesës.

Vendimi i Komisionit mbi ankesën është përfundimtar. Pas përfundimit të vendimit, Komisioni paraqet një njoftim për përfundim të ofertuesit më të favorshëm, nga e cila ditë fillon afati për lidhjen e kontratës.

#### **Lidhja e kontratës**

Sekretariati për pronë, me ofertuesin e përzgjedhur do të lidhëkontratë qiraje brenda 10 ditëve nga dita e dorëzimit të njoftimit për përfundimin e Vendimit për zgjedhjen e ofertës më të favorshme, d.m.th. nga dita e marrjes së Vendimit, nëse njoftimi nuk duhet të dorëzohet në përputhje me ftesën publike.

Numër:09-032/21-7150

Tuz, 19.05. 2021

